



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

**“PËR NGRITJEN E KOMITETIT KOMBËTAR PËR BASHKËPUNIMIN
TERRITORIAL EVROPIAN”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË
ARRIHEN**

Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor është angazhuar në përgatitjen e këtij projektvendimi në përputhje me fushën e veprimtarisë shtetërore si negociator përgjegjës për Kapitullin 22 parashikuar në VKM-në nr.775, datë 13.12.2024 *“Për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe trajtimin financiar të grupit negociator dhe detyrat e Kryenegociatorit për zhvillimin e negociatave të aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”*.

Objekt i këtij projektvendimi është:

- Krijimi i një mekanizimi koordinues dhe konsultues për pjesëmarrjen e njësive të vetëqeverisjes vendore shqiptare në programimin të gjitha programet e Bashkëpunimit Territorial Evropian (të njohura si Programet INTERREG dhe IPA), si pjesë e Politikës së Kohezionit të BE-së;
- Rritjen e angazhimit të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të tjera vendase në lidhje me Strategjinë e BE-së për Rajonin Adriatiko-Jonian (EUSAIR);

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE**

Miratimi i këtij vendimi parashikohet në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2025–2027.

Ky projektvendim është në përputhje me “Programin e Qeverisë 2021-2025”.

Ky projektvendim është në përputhje edhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 (SKZHI), miratuar me vendimin nr.88, datë 22.02.2023, të Këshillit të Ministrave (përfshirja e dimensionit të zhvillimit vendor nëpërmjet rritjes të bashkëpunimit dhe koordinimit me njësitë e qeverisjes vendore).

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nëpërmjet këtij projektvendimi parashikohet krijimi i Komitetit Kombëtar për Bashkëpunimin Territorial Evropian. Ky komitet synon të garantojë zbatimin e parimit të qeverisjes në shumë nivele në kuadër të Bashkëpunimit Territorial Evropian dhe Strategjisë së Bashkimit Evropian për Rajonin Adriatiko-Jonian (EUSAIR), si dhe të formalizojë më tej rolin konsultativ të njësive të vetëqeverisjes vendore me institucioneve të tjera të qeverisjes qendrore në kuadër të integritetit në BE.

Ky projektakt adreson edhe rekomandimin e Raportit Vjetor të Zgjerimit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2024¹, i cili thekson se: *“Qytetet shqiptare tashmë marrin pjesë në pesë rrjete URBACT dhe duhet nxitur më tej bashkëpunimi si në kuadër të URBACT ashtu edhe në rrjetet Interreg Europe. Pritet një rritje e angazhimit të aktorëve shqiptarë në kuadër të Strategjisë së BE-së për Rajonin Adriatiko-Jonian.”*

Programet e Bashkëpunimit Territorial Evropian (BTE) janë pjesë e Politikës së Kohezionit të BE-së dhe ofrojnë mundësi të vlefshme për njësitë e vetëqeverisjes vendore në projekte të bashkëpunimit ndërkufitar (Interreg A), transnacional

¹ https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf

Fq.91

(Interreg B) dhe ndërrajonal (Interreg C), për të promovuar zhvillim të integruar dhe të qëndrueshëm rajonal, si dhe shkëmbim përvojash, ndërtim kapacitetesh dhe qeverisje të përmirësuar bashkëpunimi. Këto programe janë aktualisht e vetmja mundësi për njësitë e vetëqeverisjes vendore për të marrë pjesë në programet e Politikës së Kohezionit të BE-së dhe përbëjnë një mundësi të rëndësishme për përgatitjen e vendit për anëtarësimin në BE dhe pjesëmarrjen e ardhshme në programet si shtet anëtar.

Aktualisht, Republika e Shqipërisë merr pjesë në këto programe:

- INTERREG A, konkretisht në programin “Adriatiku Jugor 2021–2027”; dhe
- “INTERREG VI-A IPA Greqi–Shqipëri 2021–2027”;
- në dy programe transnacionale INTERREG B: përkatësisht “Interreg IPA ADRIION 2021–2027” dhe “Interreg Euro-MED 2021–2027”;
- si dhe në programet ndërrajonale URBACT dhe Interreg Europe, si edhe në programin ESPON me status vëzhgues¹.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në programin ndërrajonal (INTERREG C) nuk ka përfshirje në fazën e programimit. Për më tepër, Republika e Shqipërisë merr pjesë në tre programe të bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje IPA. Megjithatë, fokusi kryesor i Komitetit Kombëtar për Bashkëpunimin Territorial Evropian është perspektiva e së ardhmes dhe përqendrohet në programet INTERREG.

Komiteti Kombëtar për Bashkëpunimin Territorial Evropian nuk krijon mbivendosje me Komitetet Monitoruese të Programeve përkatëse, pasi nuk ka rol monitorues por vetëm këshillues. Komiteti do të ushtroj detyrat krahas Komiteteve Monitoruese të Programeve të INTERREG sipas legjislacionit të BE-së.

Edhe pse krijimi i një Komiteti Kombëtar për Bashkëpunimin Territorial Evropian nuk është një detyrim i mirëfilltë në kuptim të përafrimit/harmonizimit me legjislacionin e BE-së, ai përbën praktikë të mirë, ndjekur nga shtete anëtare dhe vende të rajonit, si Italia apo edhe Kroacia (*Komiteti Kombëtar për Koordinimin e Pjesëmarrjes Kroate në Programet Transnacionale dhe Ndërrajonale si dhe në Strategjitë Makrorajonale të BE-së për periudhën 2014–2020*).

Ky Komitet krijon premisat për zbatimin e parimit të qeverisjes në shumë nivele (qendrore/vendore) si dhe krijon një mekanizëm formal konsultimi dhe ndërveprimi midis këtyre niveleve për efekt të programeve INTERREG. Duke marrë parasysh se përfaqësimi në Komitetet Monitoruese të programeve transnacionale dhe ndërrajonale është i kufizuar për çdo shtet anëtar, pjesëmarrja e njësive të vetëqeverisjes vendore është e pamjaftueshme. Për programet INTERREG A ndërkufitare, në programin “Adriatiku Jugor” nuk ka përfaqësues shqiptarë në Komitetin Monitorues, ndryshe nga programi INTERREG Greqi–Shqipëri ku janë të përfaqësuar Këshilli i Qarkut Korçë, Këshilli i Qarkut Fier dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV).

Për sa më sipër, krijimi i Komitetit Kombëtar për Bashkëpunimin Territorial Evropian përbën mjetin më efektiv dhe efikas për të garantuar përfshirjen e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe autoriteteve të tjera të qeverisjes qendrore, të cilat janë përfituesit kryesorë të programeve të BTE dhe palë të rëndësishme në këtë proces.

Përmes këtij Komiteti, njësitë e vetëqeverisjes vendore do të mund të konsultohen gjatë programimit të programeve BTE dhe të informohen për mundësitë që ofrohen për aplikantët vendas. Në mënyrë të veçantë, Komiteti do të nxisë bashkëpunimin në kuadër të rrjeteve URBACT dhe INTERREG Europe, si dhe rritjen e përfshirjes së aktorëve shqiptarë në EUSAIR.

Për rrjedhojë, Komiteti përfaqëson një instrument juridik të rëndësishëm për Bashkëpunimin Territorial Evropian, i cili përbën qëllimin e dytë të Politikës së Kohezionit të BE-së.

Gjithashtu, Komiteti do të ndihmojë në identifikimin dhe adresimin e pengesave që lidhen me pjesëmarrjen e njësive të vetëqeverisjes vendore apo institucioneve të tjera vendase në projektet INTERREG si partnerë, duke kontribuar kështu në përgatitjen e strukturave kombëtare për marrjen e rolit të Autoritetit Menaxhues pas anëtarësimit të Shqipërisë, për programet INTERREG që përfshijnë vende jo-anëtare të BE-së, si Kosova dhe potencialisht Maqedonia e Veriut.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Baza ligjore mbi të cilën është hartuar ky projektvendim është nenit 100 të Kushtetutës, si dhe neni 110 i Ligjit nr.9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim ka për qëllim harmonizimin me *Acquis Communautaire* dhe specifikisht me Rregulloren për Bashkëpunimin Territorial Evropian (Rregullorja (BE) 2021/1059) që përcakton si objektiv specifik “*Qeverisje më e mirë e bashkëpunimit*” .

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Nga pikëpamja teknike, projektvendimi përmban 7 pika.

Në **pikën 1** parashikohet ngritja dhe funksionimi i Komitetit Kombëtar për Bashkëpunimin Territorial Evropian, që do të shërbej si organ këshillimor (konsultativ) pranë negociatorit përgjegjës për Kapitullin 22 “Politikat Rajonale të BE-së”. Ky Komitet do të shërbej si mekanizëm për bashkërendimin e veprimtarive shtetërore në programimin e programeve ndërkufitare INTERREG dhe IPA pas vitit 2027. Komiteti përbën një instrument ligjor për të siguruar pjesëmarrjen së autoriteteve shqiptare në grupet e punës dhe komitetet përkatëse të programimit për programet ndërkufitare INTERREG dhe IPA, si dhe të mundësojë përcjelljen e mendimeve dhe komenteve të tyre pranë këtyre strukturave.

Pika 2 rregullon përbërjen e Komitetit, duke përfshirë edhe kryesimin nga Drejtori i Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC). Komiteti ka në përbërjen e tij 7 (shtatë) anëtarë. Përbërja garanton pjesëmarrje të qeverisjes qendrore dhe vendore, në përputhje me

kompetencat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për secilin prej tyre. Propozohet që përveç SASPAC, qeverisja qendrore të përfaqësohet edhe me Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) dhe Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Nga ana tjetër, qeverisja vendore përfaqësohet nga 3 (tre) përfaqësues, kryetar bashkie, të zgjedhur nga shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë (SHKBSH), duke garantuar pluralitet politik dhe përfaqësim gjeografik dhe territorial si dhe 1 (një) përfaqësues i zgjedhur nga shoqata e Qarqeve. Ky rregullim reflekton edhe parashikimet në VKM nr.244, datë 17.04.2024 *“Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore”*.

Në pikën 3 parashikohet fusha e veprimtarisë së Komitetit që përfshin:

- a. Promovimin dhe koordinimin e pjesëmarrjes së njësive të qeverisjes vendore në të gjitha programet e Bashkëpunimit Territorial Evropian;
- b. Identifikimin e çdo pengese strukturore që ndikon në pjesëmarrjen e njësive të qeverisjes vendore në programet e Bashkëpunimit Territorial, si dhe mekanizmat për mënjanimin e tyre;
- c. Siguron angazhimin dhe konsultimin e aktorëve të ndryshëm në nivele të ndryshëm qeverisje në lidhje me Strategjinë e Bashkimit Evropian për Rajonin Adriatiko-Jonian (EUSAIR);
- ç. Garantimin e pjesëmarrjes së njësive të qeverisjes vendore shqiptare në procesin e programimit në nivel kombëtar për programet e bashkëpunimit territorial INTERREG dhe IPA;
- d. Shpërndarjen e rezultateve të projekteve të Bashkëpunimit Territorial Evropian dhe praktikave më të mira;

Në pikën 4 parashikohen frekuenca e takimeve të Komitetit. Kështu parashikohet që Komiteti të mbledhet jo më pak se një herë në gjashtë muaj dhe sa herë është e nevojshme, me kërkesë të Kryetarit.

Pika 5 parashikon mënyrën e organizimit të mbledhjeve që mund të zhvillohen edhe në formë elektronike (online). Gjithashtu, në mbledhjet e Komitetit mund të ftohen të marrin pjesë dhe përfaqësues të organeve të qeverisjes qendrore e vendore apo të institucioneve apo aktorëve të tjerë, pjesëmarrja e të cilëve vlerësohet e nevojshme për përmbushjen e misionit.

Parashikimet e pikës 6 kanë të bëjnë me Sekretariatin Teknik që do të mbështesë veprimtarinë e Komitetit. Sekretariati parashikohet të ngrihet pranë SASPAC dhe kryen këto detyra:

- a. Grumbullon dhe përpunon komentet, sugjerimet dhe propozimet e anëtarëve të Komitetit dhe njësisë të tjera të vetëqeverisjes vendore në procesin e konsultimit;
- b. Ndihmon dhe mbështet Komitetin me analizë ligjore dhe teknike në lidhje me programet, si dhe në punën dhe mbarëvajtjen e takimeve.
- c. Kujdeset për mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve të punës.
- ç. Organizon panele diskutimi dhe konsultimi për tematika specifike me anëtarët e Komitetit dhe aktorë të niveleve të ndryshme të qeverisjes.
- d) Kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Komiteti.

Në pikën 7 parashikohet afati brenda të cilit shoqatat: Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë (SHKBSH) dhe Shoqata e Qarqeve do të përzgjedhin dhe njoftojnë anëtarët e Komitetit.

Në pikën 8 renditen institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi: Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, SASPAC, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Projektvendimi parashikon hyrjen në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen:

- Agjencia Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC),
- Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV); dhe
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit;
- Si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Sekretariati Teknik i GNPIE për Kapitullin 22, me asistencën e projektit të BE-së për Kapitullin 22. Projektvendimi i është konsultuar me anëtarë të GNPIE dhe përfshin komentet e tyre.

Projektvendimi do të diskutohet edhe në Këshillin Konsultativ në përputhje me parashikimet e VKM nr.244, datë 17.04.2024 “*Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të qeverisjes qendrore me vetëqeverisjen vendore*”, si dhe do t’i dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociator, Agjencisë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndhmës (SASPAC), si dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky Vendim nuk ka efekte financiare.

MINISTRI I SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR

Arbjan MAZNIKU